



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 3138/2 Prot.

Tiranë, më 14.7.2023

URDHËR
Nr. 393, datë 14.7.2023

PËR
HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË
FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE, NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI",
VLORË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 35 dhe 81, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të vendimit nr. 427, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave për përfshirjen e kualifikimeve për të nxënësit gjatë gjithë jetës, sipas niveleve të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, për arsimin dhe formimin profesional" dhe udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2023, "Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike", i ndryshuar.

URDHËR O J:

1. Hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, që realizohet me 35 kredite dhe kohëzgjatje normale 1 (një) semestër, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet certifikatë për formimin psiko-pedagogjik në Departamentin e Edukimit, në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë, në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, në Departamentin e Edukimit, në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë, në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, fillon brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga miratimi i urdhrit të hapjes.
3. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së certifikatës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

4. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti "Ismael Qemali", Vlorë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EVIS KUSHI

